

**V E N D I M**

**I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE SHOQERISE TREGTARE**

**Investment Joti-InfoSoft Group sh.p.k.**

**Nr.138, Date 16.06.2021**

Sot me date 16.06.2021, u mblodh Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve te Shoqerise Investment Joti-InfoSoft Group sh.p.k, shoqeri e formuar sipas ligjit shqiptar dhe e regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit, me seli ne adresen Rruga "Murat Toptani", Gjergji Center, Tirane, te evidentuar si me poshte:

1. **Z. Grigor Joti**, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, lindur ne Korçe, me date 13.02.1956, mbajtes i pasaportes me nr.BF6637695 dhe nr.personal F60213094Q, i cili zoteron 80% te kapitalit te Shoqerise.
2. **Znj. Marjeta Joti**, shtetase shqiptare, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar, lindur ne Tirane me 13.04.1962, mbajttese e leternjoftimit Nr.034901970 dhe nr.personal G25413134Q, e cila zoteron 20% te kapitalit te Shoqerise.

Meqenese plotesohet kuorumi i nevojshem Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme lidhur me çeshtjen e rendit te dites, konkretisht:

1. Diskutim per kapitalizimin e fitimit te vitit financiar 2019;
2. Diskutim per destinimin e fitimit te vitit financiar 2020;

**Kushtet paraprake:**

- Referuar Vendimit te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve Nr.126, date 30.06.2020 "Per destinimin e fitimit te vitit 2019", ortaket vendosen qe fitimi i vitit 2019 ne vleren 948,946,055 (nenteqind e dyzete e tete milion e nenteqind e dyzete e gjashte mije e pesedhete e pese) Leke, te mbahet si rezerve per investime te shoqerise Investment Joti-InfoSoft Group sh.p.k.
- Ortaket deshirojne qe fitimi i vitit 2019, i mbajtur si rezerve per investime, te perdoret si shtese ne kapitalin e shoqerise Investment Joti – InfoSoft Group sh.p.k.

Ne perfundim te diskutimeve mbi çeshtjen e rendit te dites, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve me unanimitet,

**VENDOSI:**

**I. Pika e pare e rendit te dites:**

1. Ortaket vendosin qe vlera e fitimit neto te vitit financiar 2019, e mbajtur si rezerve per investime te shoqerise, ne shumen 948,946,055 (nenteqind e dyzete e tete milion e nenteqind e dyzete e gjashte mije e pesedhete e pese) Leke, te perdoret si shtese ne kapitalin e shoqerise Investment Joti – InfoSoft Group sh.p.k.



2. Sa me siper, Ortaket vendosin te zmadhojne kapitalin e shoqerise Investment Joti – Infosoft Group sh.p.k. me vleren 948,946,055 (nenteqind e dyzete e tete milion e nenteqind e dyzete e gjashte mije e pesedhjetete e pese) Leke, nepermjet zmadhimit te vleres nominale te kuotave.
3. Vlera e kapitalit te shoqerise Investment Joti – Infosoft Group sh.p.k. ishte 100 (njeqind) Leke, dhe pas zmadhimit te tij, behet 948,946,155 (nenteqind e dyzete e tete milion e nenteqind e dyzete e gjashte mije e njeqind e pesedhjetete e pese) Leke, si ne tabelen me poshte:

Nr.	Ortaku	Vlera e kapitalit para zmadhimit		Vlera e kapitalit pas zmadhimit		Pjesemarrja ne % para/pas
		Ne para	Ne natyre	Ne para	Ne natyre	
1	Grigor Joti	80 Leke	0 Leke	759,156,924 Leke	0 Leke	80%
2	Marjeta Joti	20 Leke	0 Leke	189,789,231 Leke	0 Leke	20%
<b>Total</b>		<b>100 Leke</b>	<b>0 Leke</b>	<b>948,946,155 Leke</b>	<b>0 Leke</b>	<b>100%</b>

## II. Pika e dyte e rendit te dites:

1. Referuar Vendimit te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve Nr.137, date 16.06.2021 "Per miratimin e pasqyrave financiare 2020" si dhe pasqyrave financiare vjetore per vitin financiar 2020, kompania rezulton me fitim neto ne vleren 849,542,894 (teteqind e dyzete e nente milion e peseqind e dyzete e dy mije e teteqind e nentedhjetete e kater) Leke.
2. Ortaket vendosin te destinojne fitimin e vitit 2020, duke e mbajtur si rezerve per investime te shoqerise Investment Joti-Infosoft Group sh.p.k, si me poshte vijon:
  - Mundesi per investime kundrejt shoqerive bija per t'i paraprire nevojave/ situatave te paparashikuara.
  - Perballimi i situates se paqendrueshme te shkaktuar nga pandemia e Covid-19.

Depozitim e ketij Vendimi prane Qendres Kombetare te Biznesit dhe organeve tatimore.

Meqenese nuk kishte me ceshtje te tjera per te diskutuar jashte rendit te dites, mbledhja u deklarua e mbyllur.

Grigor JOTI

ORTAKET:



Marjeta JOTI

R. Dypi  
Dt. 16.06.2021